



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:226116

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05527506

**C-IV-22-0337**

*Ankuesit*

1. I S
2. Xh H
3. R I
4. H M
5. J E
6. A A
7. S S
8. L M
9. G M
10. Xh M
11. J S
12. Rr S
13. A N
14. B L
15. R M1
16. R M2 *te përfaqësuar nga K A, Ferizaj.*

*Kundër*

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. “Dritan Hoxha ”, Nr.55, Prishtinë.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), gjyqtarja Diellza Hoxha, më 29 mars 2024 , lëshon këtë:

## A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** pjesërisht ankesa e **I S** ndryshohet **Vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI012-121** i datës **13.11.2013** lidhur me kompensimin e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.
- II. OBLIGOHET** e paditura AKP që ankuesit **I S** në emër të kompensimit të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, t'i paguaj shumën prej **1000.00 Euro**, si dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t'i paguaj **shumën prej 100.00 Euro** të cilat do të paguhen në procedurën e likuidimit sipas prioriteteve të kërkesave dhe interesave, sipas nenit 40 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së ( Ligji nr. 04/L-034).  
Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit
- III. REFUZOHEN** si të pabazuara ankesat e ankuesve lidhur me pagat e pa papaguara **VËRTETOHEN** vendimet e Autoritetit të Likuidimit **Nr. GJI012-0120; Nr. GJI012-0122; Nr. GJI012-0021; Nr. GJI012-0151; Nr. GJI012-0123; Nr. GJI012-0125; Nr. GJI012-0124; Nr. GJI012-0006; Nr. GJI012-0013; Nr. GJI012-0020; Nr. GJI012-0010; Nr. GJI012-0023; Nr. GJI012-0019; Nr. GJI012-0011; Nr. GJI012-0017; Nr. GJI012-0012; Nr. GJI012-0014**, të datës 8 dhe 13 nëntor 2013, si të drejtë dhe të bazuara në ligj.
- IV.** Nuk caktohen taksa gjyqësore për Ankuesit.

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me datë 11 dhjetor 2013, Ankuesit parashtruan ankesë grupore në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit **Nr. GJI012-0120; Nr. GJI012-0121; GJI012-0122; Nr. GJI012-0021; Nr. GJI012-0151; Nr. GJI012-0123; Nr. GJI012-0125; Nr. GJI012-0124; Nr. GJI012-0006; Nr. GJI012-0013; Nr. GJI012-0020; Nr. GJI012-0010; Nr. GJI012-0023; Nr. GJI012-0019; Nr. GJI012-0011; Nr. GJI012-0017; Nr. GJI012-0012; Nr. GJI012-0014** të datës 08.11.2013 dhe 13.11.2013 .

Në ankesë parashtruesit kërkojnë kompensimin për paga të papaguara, kompensimin e tri pagave të fundit të papaguara, si dhe kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës, nga Ndërmarrja Shoqërore “Plantacioni i Pemëve” (Në Likuidim). Ndërmarrja Shoqërore në fjalë, “Plantacioni i Pemëve”, është privatizuar me datë 10 shkurt 2005. Si rrjedhojë e privatizimit,

Ankuesit pretendojnë se nga ai moment të gjithë punëtorët e kësaj ndërmarrje kanë humbur vendin e tyre të punës. Më tej, Ankuesit pretendojnë që arsyetimi i dhënë nga ana e Autoritetit të Likuidimit për refuzimin e kërkesave të parashtruesve është në kundërshtim të plotë me ligjin në fuqi. Ankuesit arsyetojnë pretendimin e tyre, se me fillimin e privatizimit të ndërmarrjes shoqërore, të gjithë punëtorët e kësaj ndërmarrje janë udhëzuar nga ana e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit si në vijim:

*“Shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e Punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura.”*

Ankuesit, duke u bazuar në këtë njoftim të AKM, pretendojnë që janë udhëzuar nga kjo e fundit që t'i paraqesin kërkesat e tyre kreditore në procedurën e likuidimit. Për më shumë, Ankuesit thirren në nenin 387 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimeve, i cili thekson se parashkrimi ndërpritet kur debitori pohon borxhin. Sipas Ankuesve, pohimi i borxhit është bërë në mënyrë të drejtpërdrejt nga ana e ndërmarrjes shoqërore, por edhe nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit me rastin e udhëzimeve drejtuar punëtorëve për dorëzimin e kërkesave të tyre në procedurë të likuidimit.

Më poshtë do të përmbledhim rrethanat faktike për secilin ankues veç e veç :

- 1. IS** ka parashtruar ankesa kundër vendimit GJI012-0120 te datës 13 nëntor 2013 me te cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim te pagave te papaguara ne shume prej 750.00 euro , vendimit GJI012-0121 te datës 13 nëntor 2013 me te cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje te parakohshme te kontratës se punës ne shume te pacaktuar si dhe kundër vendimit GJI012-0122 te datës 13 nëntor 2013 me te cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensimin e pagave te papaguar nga viti 1994-1999 te gjitha kërkesat janë refuzuar mbi bazën e parashkrimit .

Ne mbështetje te ankesës ka bashkangjitur :

- Vendimet e AL GJI012-0120; GJI012-0121; GJI012-0122 te datës 13.11.2013
- Kopjen e letër pezullimit te lëshuar nga AKM te datës 4 mars 2005
- Kopjen e librezes se punes.
- Listën e pagave te papaguara për muajt dhjetor 2004, janar- shkurt 2005 te lëshuar nga menaxhmenti i NSH-se te datës 01.03.2005 .
- kopjen e listës përfundimtare për përfitimin e 20%

**2. Xh H** , ka parashtruar ankesë ndaj vendimit GJI012-0021, të datës 08 nëntor 2013 me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa kompensimin e tre pagave te paguar ne shume prej 450.00 euro .Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur:

- Vendimin GJI012-0021 të datës 08 nëntor 2013.

**3. R I** , ka parashtruar ankesë ndaj vendimit GJI012-0151 të datës 13 nëntor 2013 me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensimin e pagave te papaguar per katër muaj nga maji 2008 ne shume prej 800.00 euro si dhe ndaj vendimit GJI012-0123 te datës 13 nëntor 2013 me te cilin ishte refuzuar kërkesa per dhe tri paga te papaguar ne shume totale prej 615.00 euro .Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur

- Vendimet GJI012-0151 dhe GJI012-123 të datës 13 nëntor 2013 ,

**4. H M** ka parashtruar ankesë ndaj vendimit GJI012-0125 të datës 13 nëntor 2013 me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensimin e tre pagave te papaguara ne shume prej 450 euro. Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur :

- Vendimin GJI012-0125 te datës 13 nëntor 2013 asnjë prove tjetër.

**5. J E** ka parashtruar ankesë ndaj vendimit GJI012-0008, të datës 08 nëntor 2013 me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa kompensimin e tre pagave te papaguara ne shume prej 450.00 euro .

Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur:

- Vendimin GJI012-0008 të datës 08 nëntor 2013.

**6. A A** ka parashtruar ankesë ndaj vendimit GJI012-0124, të datës 13 nëntor 2013 me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa kompensimin e tre pagave te papaguara ne shume prej 450.00 euro .

Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur:

- Vendimin GJI012-0124 të datës 13 nëntor 2013.

**7. S S** ka parashtruar ankesë ndaj vendimit GJI012-0006, të datës 08 nëntor 2013 me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa kompensimin e tre pagave te papaguara ne shume prej 450.00 euro .

Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur:

- Vendimin GJI012-0006 të datës 08 nëntor 2013.

**8. L M** ka parashtruar ankesë ndaj vendimit GJI012-0013, të datës 08 nëntor 2013 me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa kompensimin e tre pagave te papaguara ne shume prej 450.00 euro .

Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur:

- Vendimin GJI012-0013 të datës 08 nëntor 2013.

- **9. G M** ka parashtruar ankesë ndaj vendimit GJI012-0020, të datës 08 nëntor 2013 me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa kompensimin e tre pagave te papaguara ne shume prej 450.00 euro .

Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur:

- Vendimin GJI012-0020 të datës 08 nëntor 2013.

**10. Xh M** ka parashtruar ankesë ndaj vendimit GJI012-0010, të datës 08 nëntor 2013 me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa kompensimin e tre pagave te papaguara ne shume prej 450.00 euro .

Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur:

- Vendimin GJI012-0008 të datës 08 nëntor 2013.

-

**11. J S** ka parashtruar ankesë ndaj vendimit GJI012-0023, të datës 08 nëntor 2013 me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa kompensimin e dëmshpërblimit për ndërprerje te parakohshme te kontratës se punës ne shume te pacaktuar .

Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur:

- Vendimin GJI012-0023 të datës 08 nëntor 2013.

-

**12. Rr S** ka parashtruar ankesë ndaj vendimit GJI012-0019, të datës 08 nëntor 2013 me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa kompensimin e tre pagave te papaguara ne shume prej 450.00 euro .

Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur:

- Vendimin GJI012-0019 të datës 08 nëntor 2013.

**13. A N** ka parashtruar ankesë ndaj vendimit GJI012-0011, të datës 08 nëntor 2013 me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa kompensimin e tre pagave te papaguara ne shume prej 450.00 euro .

Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur:

- Vendimin GJI012-0011 të datës 08 nëntor 2013.

**14. B L** ka parashtruar ankesë ndaj vendimit GJI012-0017, të datës 08 nëntor 2013 me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa kompensimin e tre pagave te papaguara ne shume prej 450.00 euro .

Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur:

- Vendimin GJI012-0017 të datës 08 nëntor 2013.

**15.R M1** ka parashtruar ankesë ndaj vendimit GJI012-0012, të datës 08 nëntor 2013 me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa kompensimin e tre pagave te papaguara ne shume prej 450.00 euro .

Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur:

- Vendimin GJI012-0012 të datës 08 nëntor 2013.
- 

**16. R M2** ka parashtruar ankesë ndaj vendimit GJI012-0014, të datës 08 nëntor 2013 me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa kompensimin e tre pagave te papaguara ne shume prej 450.00 euro .

Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur:

- Vendimin GJI012-0014 të datës 08 nëntor 2013

Me datë 25 shtator 2018, e paditura Agjencia Kosovare e Privatizimit parashtrroi mbrojtje në ankese duke kundërshtuar të gjitha pretendimet e ankuesve të paraqitur në ankese duke i konsideruar si të pabazuara në ligj dhe si të tilla duhen të refuzohen. AKP, në mbrojtje, ka pohuar qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit se ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktë. E paditura në mbrojtjen e saj thirret në Shtojcën e Ligjit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, neni 36.2.1., si dhe në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (Gazeta Zyrtare RSFJ, Nr. 53, 1976),

Me datë 5 tetor 2018, Ankuesit parashtruan përgjigje në mbrojtjen e AKP-së. Ankuesit arsyetojnë që dispozita ligjore e nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar nuk është dispozitë ligjore e cila buron nga një ligj në fuqi në Kosovë. Sipas paditësve, ligji në fjalë është shfuqizuar me ligjin për ndërmarrjet të vitit 1998 , si dhe ligjet tjera të mëvonshme të punës. Në përfundim të përgjigjes, Ankuesit i propozojnë Gjykatës që të miratoj kërkesën e punëtorëve lidhur me dëmshpërblimin, ashtu siç është përshkruar në ankesë, me kamatë ligjore prej 8%, të llogaritur që nga dita e rënies në vonesë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1.872.00 Euro, si dhe shpenzimet tjera procedurale deri në fund të këtij kontesti gjyqësor.

Me datë 16 tetor 2018, pala e paditur parashtrroi kundërpërgjigje në përgjigjen e ankuesve duke mbetur në tërësi pranë deklarimeve dhe kundërshtimeve të parashtruar në mbrojtje. Sipas palës së paditur, Ankuesit nuk kanë paraqitur ndonjë provë, dëshmi, apo fakt të ri për të cilat Agjencia, përkitazi me përgjigjen e parashtruar nga paditësi, do të mund të deklarohet dhe të paraqes kundër-argumentet e saja. Si rrjedhojë, për pasojë që paditësi në përgjigjen në mbrojtje nuk ka paraqitur prova dhe dëshmi relevante për ta bërë të besueshme kërkesëpadinë, AKP kërkon nga kjo Gjykatë që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar në ligj.

Gjykata me Aktgjykimin C-IV-13-3702 te datës 07 tetor 2021 refuzoi ankesat e ankuesve . Kundër këtij Aktgjykimi ankuesit kane parashtruar ankese ne Kolegjin e Apelit .

Kolegji i Apelit me aktvendimin AC-I-21-0703 te datës 20 tetor 2022 anuloi Aktgjykimin e shkallës se parë dhe lëndën e ktheu ne rigjykim . Lënda morri numrin C-IV-22-0337

Me 02 maj 2023 Gjykata lëshoi urdhër për ankuesit që të parashtrorjnë prova shtese : te gjitha vendimet e kundërshtuara te AL, kopjet e librezës se punës, kopjen e njoftimit për ndërprerjen e punës për te gjithë ankuesit, liste te pagave, lista për pagat e mbetura borxh .

Me 19 maj 2023 përfaqësuesi i ankuesve parashtrroi përgjigjen ne urdhër te gjykatës duke precizuar kërkesat e ankuesve te cilet kerkojne kompensimin per paga te papaguara , per demshperblim te nderprerjes te parakohshme te kontrates se punes ne baze te stazhit te punes dhe parashtrroi :

- vendimet e AL lidhur me 3 paga te papaguara ,
- 3 vendime te AL vetëm për I Sn, letër pezullimin dhe kopjen e librezës se punës,
- Një liste te pagave te papaguara te lëshuar nga NSH “Plantacioni i Pemëve” nr. 02/13 me 01.03.2005.
- kopjen e listës përfundimtare për përfitimin e 20% . Prova tjera te kërkuar nuk ka paraqitur .

Gjykata me 08 shkurt 2024 ka mbajtur seancë dëgjimore.

Ne seancën dëgjimore te mbajtur me 08 shkurt 2024 përfaqësuesi i ankuesve mbeti pranë pretendimeve në ankesë si dhe përgjigjes në mbrojtën e AKP-së. Ai edhe ne seancë dëgjimore ritheksoi se këtyre punëtorëve i është ndërprerë marrëdhënia e punës si pasoje e shitjes se asetëve pra si rezultat i ushtrimit te autorizimeve te Agjencisë nga neni 6.2 i Ligjit 04/L-034. Prove tjetër

nuk parashtrori përveç një letër pezullim të cilin e parashtrori vet ankuesi Xh M. Përfaqësuesi i ankuesve i propozojë Gjykatës që të miratoj ankesat e tyre lidhur me dëmshpërblimin, ashtu siç është përshkruar në ankesë me kamatë ligjore prej 8%, të llogaritur që nga dita e rënies në vonesë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1.872.00 Euro

Përfaqësuesja e AL-se edhe në seancën dëgjimore mbeti pranë të gjitha kundërshtimeve të paraqitura si në vendime ashtu në mbrojtje duke ritheksuar se të gjitha kërkesat kreditore të ankuesve janë refuzuar nga ana e AL-se sikurse të pavlefshme për shkak të parashkrimit, lidhur me kërkesat për kompensim për ndërprerje të marrëdhënies së punës deklaroi se ata nuk kanë parashtruar kërkesa në AL për këtë arsye nuk i posedojnë këto vendime . Gjykatës i propozoi që ankesat të refuzohen dhe të vërtetohen vendimet e AL.

### **Arsyetimi ligjor**

Gjykata pas shqyrtimit të gjithanshëm të ankesave të gjitha provave të bashkangjitura dhe atyre të grumbulluara gjatë procedurës me shkrim si dhe deklaratave në seancën dëgjimore konstaton se ankesa grupore është pjesërisht e bazuar vetëm për ankuesin I S dhe ndërsa për ankuesit tjerë refuzohet si e pabazuar .

**I S, Vendimet Nr. GJI012-0120; GJI012-0121; GJI012-0122 te datës 13.11.2013.**

Ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar .

Ankuesi kërkon nga kjo Gjykatë kompensimin për tri paga të papaguara, në shumën prej 750.00 Euro, dëmshpërblimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë të pacaktuar, si dhe kompensimin për paga të papaguara për periudhën nga qershori i vitit 1994 – shtator 1999, në shumë të pacaktuar. Të gjitha këto kërkesa ishin refuzuar si të pabazuara nga Autoriteti i Likuidimit mbi bazën e parashkrimit.

Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur :

- Vendimet e AL GJI012-0120; GJI012-0121; GJI012-0122 te datës 13.11.2013
- Kopjen e letër pezullimit të lëshuar nga AKM te datës 4 mars 2005
- Kopjen e librezes së punës.



- Listën e pagave të papaguara për muajt dhjetor 2004, janar- shkurt 2005 të lëshuar nga menaxhmenti i NSH-se të datës 01.03.2005 .
- kopjen e listës përfundimtare për përfitimin e 20%

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në Gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se njëra ndër çështjet thelbësore kontestuese ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit.

Gjykata gjen se neni 608 i ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së, ishte shfuqizuar me Ligjin mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Ndërmarrjet (GZ 40/89), i cili ligj kishte hyrë në fuqi me 15 korrik 1989, konkretisht me nenin 74, i cili nen e plotëson Ligjin mbi Ndërmarrjet (GZ 77/88), i cili kishte hyrë në fuqi me 01 janar 1989, konkretisht nenin 196, i cili qartësisht shfuqizon të gjitha dispozitat e Ligjit mbi Punën e Bashkuar, përveç dispozitave nga Kreu IV dhe Kreu i VI kapitulli 2. Dispozita e nenit 608 është e vendosur në Kreun e VI, në kapitullin 3, që do të thotë se është shfuqizuar me këtë ndryshim plotësim të ligjit. Ligji mbi Marrëdhënien e Punës i datës 14 prill 1989 dhe Ligji për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës i datës 28 shtator 1989, nuk kanë paraparë dispozita të veçanta lidhur me parashkrimin e kërkesave monetare që lindin nga marrëdhënia e punës, megjithatë kjo nuk do të thotë se instituti i parashkrimit për kërkesat monetare ka mbetur i pa mbuluar me dispozita të tjera ligjore.

Gjykata vlerëson se për kërkesat e Ankuesit në lidhje me kompensimin e tri pagave të fundit të papaguara, si dhe kompensimin e pagave të papaguara për periudhën qershor 1994 – shtator 1999, për kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohet afati i parashkrimit për kërkesat periodike. Këto rregulla gjinden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) Nr. 690, të datës 30 mars 1978, të njëjtat rregulla gjinden edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili ka hyrë në fuqi më 19 qershor 2012. Në pajtim me nenin 353, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike, siç janë pagat, është tri (3) vjet. Ankuesi ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimeve të pretenduara në kohën kur nuk i janë paguar pagat si dhe kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Si rrjedhojë, afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë menjëherë pasi ka lindur e drejta e kërkesës lidhur me kompensimin e pagave të papaguara. Kërkesa e Ankuesit për kompensim për paga të papaguara, (kërkesa për kompensim të pagave të papaguara për periudhën qershor i vitit 1994 – shtator 1999, në shumë të pacaktuar është parashkruar brenda afatit 3 vjeçar, që nënkupton se afati i

parashkrimit ka arritur në muajin shtator të vitit 2002 , kurse kërkesa për kompensimin e tri pagave të fundit të papaguara afati i parashkrimit ka filluar nga muaji mars 2005, kur edhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës si rrjedhojë e privatizimit, që nënkupton se afati i parashkrimit ka arritur në muajin mars 2008.

Ankuesi kërkesën e tij e ka parashtruar në muajin tetor të vitit 2013, që është jashtë çdo afati të paraparë ligjor. Ankuesi, me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashkrimit të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore pagat e papaguara për të ndikuar kështu në ndryshimin e vendimit të sfiduar. Nga te gjitha te cekurat me larte Vendimet e AL GJI12-0120 dhe GJI12-0122 te datës 13.11.2013 vërtetohen .

Ndërsa, sa i përket kërkesës së Ankuesit lidhur me dëmshpërblimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, Sipas nenit 40.1.6.2 të shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Nga librezat e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte krijuar marrëdhënie pune në NSH Plantacioni i pemëve ” nga viti 1976 deri më 4 mars 2005, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Nga lista e lëshuar nga personi përgjegjës i NSH-së më datë 1 mars 2005 vërtetohet fakti se ankuesi kishte pagën 250.00 euro Gjithashtu vërtetohet fakti se NSH-ja, i kishte mbetur borxh ankuesit për kompensim për dëmshpërblim nga ndërprerja e kontratës së punës, në shumë prej 4 x 250.00 Euro, pasi që ankuesi kishte punuar në NSH 28. vjet e 91, kjo vërtetohet nga librezat e punës.

Neni 12.2 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 ( si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: “Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme:

*(dh) punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t’i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme:*

*(i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore;*

- (ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore;*
- (iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;*
- (iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;*
- (v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore;*

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte punëtor i NSH “Plantacioni i pemëve”. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Ankuesi pretendon se ka qenë punëtor deri në momentin e privatizimit të NSH dhe se me njoftimin e datës 4 mars 2005 i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe me po të njëjtin njoftim edhe udhëzuar që për çdo kërkesë kreditore që mund të ketë do të shqyrtohet sipas procedurave të likuidimit dhe se do të kontaktohet kur të fillojnë këto procedura. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar dhe se njoftimi i datës 4 mars 2005 ka të bëjë vetëm dhe ekskluzivisht me krijimin e listës së shpërndarjes së 20 % të të ardhurave nga privatizimi i NSH. E paditura nuk e ka kontestuar përvojën e punës së ankuesit.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në njoftimin e datës 4 mars 2005 si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante librezën e punës e cila është mbyllur me 4 mars 2005 dhe njoftimin e datës 4 mars 2005 lëshuar nga vet AKM, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i drejtë. Ankuesi me letrën e datës 4 mars 2005 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrorë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund të atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor

i të paditurës për fillimin e procedurës së likuidimit të NSH dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrorë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Andaj në bazë të së lartcekurave gjykata aprovoi pjesërisht ankesën e I St lidhur me kërkesën për kompensim të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës (4x 250.00 ) shumen prej 1000.00 euro ndërsa kërkesat tjera refuzohen .

**Ankesat e ankuesve Xh H ,R I , H M, J E, A A ,S S, L M, G M, Xh M, J S, Rr S, A N, B L, R M1 dhe R M2**

Gjykata pas shqyrtimit të gjithanshëm të ankesave të gjitha provave të bashkangjitura dhe atyre të grumbulluara gjatë procedurës me shkrim si dhe deklaratave në seancën dëgjimore konstaton se ankesat e ankuesve refuzohen si të pabazuara .

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast të gjithë ankuesit përveç vendimeve të atakuara nuk kanë ofruar asnjë dëshmi tjetër që të dëshmojnë se NSH i ka mbetur borxh pagat e kërkuara, asnjëri nuk ka parashtruar librezën e punës, letër pezullimin, po ashtu ankuesit nuk ka dorëzuar as ndonjë specifikacion se për cilën periudhë i kërkojnë pagat e papaguara , ankuesit nuk kanë ndonjë dëshmi lidhur me llogaritjen e pagave të kërkuara. Ankuesit në ankesë kanë kërkuar edhe dëmshpërblimin për ndërprerje të kontratës së punës por asnjëri nuk ka bashkangjitur vendimet e AL lidhur me këto kërkesa, ata kanë dështuar që të dorëzojnë prova në mbështetje të ankesës së tyre edhe pas pranimit të

mbrojtjes së të paditurës. Gjykata disa here me urdhër i ka kërkuar ankuesve provat lidhur me kërkesat tyre, ata as ne seance dëgjimore nuk kane parashtruar provat e kërkuara . Ata nuk kane parashtruar asnjë prove duke u arsyetuar se nuk i posedojnë. E paditura AL ne seancë ka theksuar se ankuesit nuk kane parashtruar kërkesa për ndërprerje andaj nuk i posedojnë këto vendime. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesve lidhur me të drejtën e tyre në kompensim për paga të pa paguara dhe dëmshpërblim për ndërprerjeje te parakohshme te marrëdhënies se punës , nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në diapozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesit kane paguar taksën gjyqësore ne shume prej 30.00 euro .

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij Aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij Aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtare,  
Diellza Hoxha